

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA
 MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJISE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY
 SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njesia Org. 5
 Org. Jedinica 5
 Org. Unit 5
 Nr. i faqeve 2
 Br. stranica 2
 No. pages 2

Nr Prot: 1150
 Broj Prot: 1150
 Prot. No: 1150
 Datum: 31.08.2021
 Date: 31.08.2021

Prishtine / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 31.08-2021
 Nr. 5 - 1150

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të kërkesës për licencim nga BPrAL- Kolegji "Fama" nr. 1150 të datës: 09.07.2021, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa e kolegjit "Fama"- Prishtinë. nr. 1150 të datës: 09.07.2021, për licencim.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, shqyrtoi kërkesën me nr. 1150 të dt. 09.07.2021 të parashtruar nga kolegji "Fama" për licencim.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga kolegji "Fama", vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse nuk ka ofruar vendimin e AKA-së për akreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në kërkesën e tij drejtuar Komisionit për licencim të BPrAL-ve.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetar i Komisionit

Burim Gashi